REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1329/2
Data/Datum/Date: 25/11/2026
Shtojca/Dodatak/Annex -2-
PRISHTINË/A (2025)

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë – Ured Ministarke Pravde – Office of the Minister of Justice

Nr. 810 /2026
Datë: 25/11/2026

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura në përputhje me nenin 10, nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 35 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtaret Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-294 për Zyrtaret Publik, si dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr.08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Znj. Fusharza Kelmendi, Udhëheqëse e Divizionit për mbikëqyrjen e të liruarëve me kusht në Shërbimin Sprovues të Kosovës, caktohet ushtruese e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ushtruesja e detyrës, e caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë e saj t'i ushtrojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

3. Obligohet Agjencia për Ndihmë Juridike Falas për zbatimin e këtij vendimi.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 335/2025, i datës 23.07.2025.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet në fuqi deri në përfundimin e procedurës së rekrutimit për pozitën e Drejtorit Ekzekutiv, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh nivelin jo të kënaqshëm të funksionimit dhe të performancës institucionale të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, si dhe nevojën për përmirësimin e menaxhimit, rritjen e efikasitetit, forcimin e llogaridhënies dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, është vlerësuar e nevojshme ndërmarrja e masave me karakter organizativ dhe menaxherial.

Gjithashtu, duke pasur parasysh se Agjencia aktualisht është pjesë e procesit të vlerësimit nga SIGMA, në kuadër të procesit të racionalizimit të agjencive ekzekutive, është e nevojshme të sigurohet një menaxhim efektiv, bashkëpunim i plotë institucional dhe adresim me kohë i sfidave që lidhen me funksionimin dhe organizimin e Agjencisë.

Në këtë drejtim, me qëllim të përmirësimit të performancës institucionale, garantimit të vazhdimësisë së menaxhimit dhe sigurimit të funksionimit të rregullt dhe të pandërprerë të

Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, është vlerësuar i nevojshëm caktimi i znj. Fusharza Kelmendi si ushtruese e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të kësaj Agjencie, deri në plotësimin e pozitës përmes procedurës së rekrutimit, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Andaj, bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi dhe në arsyet e lartcekura, është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Donika Gërvalla - Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Znj. Fusharza Kelemendi;*
- *Z. Faton Jashari;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;*
- *Shërbimit Sprovues të Kosovës;*
- *Departamentit për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Burime Njerëzore;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*